



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljenat/Prodato Received/Delivety	07-02-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	576/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1214/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër protokollit A.nr.12414/2021 të datës 23.12.2021 të parashtruar nga ankuesi përfaqësuar me autorizim nga Avokat me adresë:

Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit numër Nr.14/46 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 30.01.2021 si dhe kundër Vendimit me numër prot:3052 të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, në çështjen juridike “Ndërprerje marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.1214/2021 e datës 23.12.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET në fuqi Vendimi i Drejtorit i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes i datës datë 13.12.2021.

A r s y e t i m

Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 30.11.2021 ka nxjerr vendimin më numër Nr.14/46 me të cilin e ka shfuqizuar Vendimin e datës 11.06.2019 me numër Nr.11/46 me të cilin ankuesi ishte emëruar Drejtor i Qendrës së Mjekësisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në zbatim të vendimit numër Nr.14/46 të Qeverisë i datës 30.11.2021, Drejtorit i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes me datë 13.12.2021 ka nxjerrë vendimin me numër prot:3052 përmes të cilit ankuesin e ka liruar nga pozita e Shërbyesit Civil.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin numër Nr.14/46 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 30.11.2021 si dhe Vendimin me numër prot:3052 të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, me datë 23.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokolli:6303/2021.

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 31.12.2021 ankesën e ankuesit, e ka proceduar tek Ministria e Mbrojtjes për përgjigje në ankesë, ndërsa Ministria e Mbrojtjes me datë 12.01.2022 ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit të datës 23.12.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 15.12.2021; Vendimin me Nr.05/151 e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 02.08.2017; Propozimin e Kandidatit të FSK-së i datës 28.05.2019 me numër Ref:03/352/2019; Kërkesën e Ministrit të Mbrojtjes drejtuar ankuesit e datës 29.05.2019; Pëlqimin e ankuesit për transfer i datës 30.05.2019; Propozimin për pikën e rendit të ditës i datës 11.06.2019; Procesverbali i mbledhjes së 106 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 16.06.2019; Vendimin numër Nr.11/106 e Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 11.06.2019; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.06.2019; Vendimin numër Nr.14/46 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 30.11.2021; E-mailin e datës 09.12.2021 dërguar nga _____ për Vendimin me numër prot:3052 të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes të datës 13.12.2021; Raporti EX-POST i Auditimit të Brendshëm i periudhës nëntor 2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 31.12.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 12.01.2022; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 01.11.2008; Vendimin numër Nr.10/20 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 22.06.2011; Vendimin numër Nr.03/194 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 23.07.2014; Vendimin numër Nr.05/151 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 02.08.2017; Shkresën e datës 11.04.2019; Organogramin e Ministrisë së Mbrojtjes; Urdhrin e datës 26.04.2019; Tabelën Organizative të Personelit në Forcën e Sigurisë së Kosovës; Deklaratën e pajtueshmërisë me rregulloren e punës së Qeverisë Nr.09/2011 e datës 11.06.2019; Kërkesën e datës 21.06.2019 ministrit të Ministrisë së Mbrojtjes; Përshkrimi detyrave për pozitën e ankuesit-Drejtorit të Qendrës së Mjekësisë së FSK-së e datës 04.09.2019; Propozimin për pikë të rendit të ditës e datës 30.11.2021; Deklarata e datës 30.11.2021 për Pajtueshmërinë me Rregulloren e punës së Qeverisë Nr.09/2011; Propozim Vendimi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është ***e pabazuar, sepse:***

Ankuesit _____ me Vendimin Nr.05/151 të datës 28.05.2017 i është vazhduar mandati në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës për një mandat 3 (tre) vjeçar.

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës me datë 28.05.2019 përmes shkresës zyrtare nr.ref.03/352/2019 me të cilinë shkresë bënë propozimin që ankuesi Shkëlzen Sylja të transferohet nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Forcës së Sigurisë në pozitën “Drejtore të Qendrës Mjekësore të Forcës” (Poliklinikës). Shkresa e përmendur e Komandantit të FSK-së është bazuar në ligjin Nr. 06/123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ndërsa procedurat për transferimin e ankuesit nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes është dashur të zbatohen nga Ministri dhe vetë ankuesi duke qenë edhe Zyrtari Kryesor Administrativ në MM.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në shkresat e lëndës të dërguar nga dy palët ka konstatuar se e tëra procedura e më tutjeme nga ana e Ministrit të Mbrojtjes është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji duke trajtuar pretendimet e palës ankuese veç e veç dhe duke peshuar me kujdes të gjitha provat konform dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi (*në fuqi ka qenë Ligji për Shërbimin Civil Nr.03/L-149 dhe aktet nën ligjore të këtij ligji*) ka konstatuar se, Ministri i Mbrojtjes pas marrjes së shkresës nga ana e Komandantit të Forcës së Sigurisë për transferim/ri caktim të ankuesit me datë: 29.05.2019 ka kërkuar nga ankuesi pëlqimin

e tij përmes shkresës nr.ref.133/01/2019, për lëvizjen e ankuesit nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MM në pozitën “Drejtor i Qendrës Mjekësore të Forcës”, ankuesi me datë 30.05.2019 përmes shkresës nr.ref.217/04/2019 i është përgjigjur Ministrisë të MM, lidhur me lëvizjen e tij, duke shprehur ankuesi pajtimin se pranon lëvizjen nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm në Pozitën e “Drejtor i Qendrës Mjekësore të Forcës”.

Ministri MM lidhur me implementimin e dakordancës së lartshënuar në mesë të Komandantit të FSK-së, Sekretarit të Përgjithshëm dhe vetë MM, përmes shkresës zyrtare të datës 11.06.2019 nr.ref.234/2019 i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës që të vë në rend dite ri caktimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MM.

Në po të njëjtën ditë Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerr Vendimin nr.11/106 të datës 11.06.2019 në të cilin përcaktohet se:

“V E N D I M”

1. “Aprovohet propozimi i Ministrisë të Mbrojtjes për ristrukturimin e disa pozitave në Ministrinë e Mbrojtjes”.
2. “Autorizohet Ministria e Mbrojtjes për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me ristrukturimin e pozitave të caktuara në pajtim me legjislacionin në fuqi.”

Kolegji nga shkresat e lëndës vëren një diskrepancë të madhe në mesë të procesverbalit të mbledhjes 106 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në të cilin procesverbal diskutohet dhe aprovohet pika për ri caktimin e ankuesit nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm të MM në pozitën “Drejtor i Qendrës Mjekësore të Forcës së Sigurisë” dhe e njëjta pikë kalon pa asnjë kundërshtim, ndërsa Vendimi nr.11/106 e autorizon MM për ristrukturim të disa pozitave, prandaj për Kolegjin është e pa njohur se cila ka qenë arsye që Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka nxjerr vendim sipas procesverbalit të mbledhjes së 106.

Nisur nga kjo që u tha më lartë edhe sikur Qeveria e Republikës së Kosovës të kishte për qëllim ristrukturimin e pozitës së Sekretarit të Përgjithshëm në MM këtë nuk e lejon Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës gjegjësisht neni 15, si dhe Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes nr.06/L-122 gjegjësisht neni 7 i këtij ligji.

Për ta bërë të qartë dhe me qëllim të shterimit të gjitha argumenteve juridike lidhur me paragrafin 2 të Vendimit Nr.11/106 të datës 11.06.2019 në të cilin Qeveria e Kosovës përcakton “*Autorizohet Ministria e Mbrojtjes për ndërmarrjen e veprimeve lidhur me ristrukturimin e pozitave të caktuara në pajtim me legjislacionin*” Kolegji ndërlidhur me këtë paragraf të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës i referohet edhe Rregullores Nr. 05/2012 gjegjësisht neni 4,5,6 ku flitet për ri organizimin e institucionit, Suprimimin e institucionit, Bashkimin e një institucioni me një institucion tjetër, nëpunësit civil mundë të ri caktohen në pozitë ekuivalente apo më të ultë, POR në rastin konkret nuk kem të bëjmë me hapa të tillë, dhe siç është sqaruar më lartë pozita e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës nuk mundë të ri organizohet, të suprimohet sepse një gjë të tillë nuk e lejojnë dispozitat e lartshënuara, prandaj ri caktimi i SP në MM në mënyrën e bërë nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, sipas Kolegjit për vendosjen e ankesës së ankuesit është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe aktet nën ligjore që kanë qenë në fuqi në kohën e ri caktimit.

Kolegji për qëllime krahasimore i referohet edhe ligjit për Zyrtar Publikë Nr.06/L-114 (edhe pse është e qartë se në këtë kohë ky ligj ka qenë ende pa hyrë në fuqi) gjegjësisht:

Neni 54

Transferimi në rast mbylljes apo ristrukturimit

1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori.

...

Sipas Kolegji Qeveria ka folur lidhur me disa pozita në Ministrin e Mbrojtjes ne Vendimin Nr.11/106 dhe në kundërshtim me procesverbalin që është shkruar po në këtë mbledhje, prandaj Kolegji konstaton se, nëse Qeveria e Kosovës ka pasur për qëllim transferimin e ankuesit (ashtu siç është aprovuar në procesverbal) ka qenë dashur të nxjerr vendim taksativ të përcaktuar me emër dhe mbiemër, dhe kohën e transferimit, sepse Sekretari i Përgjithshëm është Zyrtar i Nivelit të lartë Drejtues dhe është i emëruar për një mandat 3 (tre) vjeçar dhe nuk mund të kalojë në një pozitë të përhershëm të shërbimit civil pa iu nënshtuar procedurave të rekrutimit.

Kolegji duke analizuar me kujdes dispozitat ligjore të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës gjegjësisht nenin 16 i cili përcakton se:

Neni 16

Lëvizja e zyrtarëve drejtues brenda shërbimit civil

1. Zyrtarët e lartë drejtues dhe zyrtarët drejtues në shërbimin civil, mund të caktohen në pozita të ndryshme me gradë ekuivalente për një periudhë të caktuar kohore, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj.....
3. Kushtet dhe procedurat lidhur me zbatimin e programeve të veçanta për ndërtimin e kapaciteteve dhe për lëvizjen e nëpunësve përcaktohen me rregullore nga Qeveria.

Gjithashtu Kolegji ka marr për bazë edhe Rregulloren Nr.06/2012 për Emërimin në Pozitat e Larta Drejtuese gjegjësisht:

Neni 14

Ri caktimi

1. Zyrtari i lartë drejtues mund të ri caktohet në një pozitë tjetër të nivelit të njëjtë me pajtimin e tij dhe titullarit të institucionit në të cilin punon aktualisht si dhe të titullarit të institucionit në të cilin do të transferohet. 2. Ri caktimi i zyrtarit të lartë drejtues duhet të bëhet me vendim të Qeverisë pas rekomandimit nga Kryeministri. Rrethanat në të cilat Kryeministri mund të bëjë një rekomandim të këtillë janë për plotësimin e kërkesave funksionale të qeverisë dhe nevoja për zgjidhjen e vështirësive ose kontestit mes Ministrit dhe zyrtarit përkatës të lartë drejtues.

Prandaj nisur nga dispozitat e lartshënuara ligjore dhe aktet nën ligjore që kanë qenë në fuqi, ri caktimi i ankuesit nga pozita e Sekretarit të Përgjithshëm në MM në pozitën e “Drejtor i Qendrës Mjekësore të Forcës së Sigurisë” është bërë në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara, pasi që pozita në të cilin është ri caktuar nuk është ekuivalent ose e brazvlefshme me pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm dhe po ashtu në pozitën paraprake ka qenë i emëruar me mandat ndërsa pas ri caktimit në pozitën e Drejtorit të Qendrës së Mjekësisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës të njëjtit i është lëshuar me datë 25.06.2019 akt emërimi i karrierës pa afat, dhe në asnjë pjesë në preambulën e akt emërimit të potencuar nuk janë referuar dispozitat ligjore të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës të aplikuara në kohën nxjerrjes së tij.

Kolegji më tutje shqyrton edhe bazën e rekrutimit të pozitave drejtuese në shërbimin civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil gjegjësisht:

Neni 4

Procedurat e rekrutimit

.....

Paragrafi 4. Për pozitat e larta drejtuese dhe pozitat drejtuese pranimit kryhet përmes procedurave të ngritjes në detyrë të nëpunësve civil ekzistues. Në rast se nuk ka kandidatura nga nëpunësit civilë ekzistues, apo kandidatët kanë rezultuar të pa përshtatshëm në përfundim të procesit të rekrutimit, atëherë zhvillohet procedura e hapur e rekrutimit për të gjithë kandidatët e interesuar për këto pozita.

Bazuar në shkresat e lëndës pozita në të cilën është transferuar ankuesi “Drejtor i Qendrës Mjekësore të Forcës” është pozitë drejtuese, prandaj është e qartë nga dispozita e lartshënuar që Sekretari i Përgjithshëm nuk ka mundur të transferohet nga Niveli i Lartë drejtues në nivel drejtues pa ju nënshtruar procedurës së hapur të konkursit nga rrjedhe se për atë vend pune ka qenë dashur të shpallet konkurs publikë pas shterjes së procedurës së avancimit dhe tek atëherë ankuesi do të kishte të drejtë të aplikonte.

Ndërsa interpretimit që i bënë pala ankuese nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcakton se: *“Zyrtarët e lartë drejtues dhe zyrtarët drejtues në shërbimin civil, mund të caktohen në pozita të ndryshme me gradë ekuivalente për një periudhë të caktuar kohore, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj. 2. Me miratimin e zyrtarit dhe propozimin e institucionit, ai mund të caktohet për një periudhë të pacaktuar kohore në një pozitë”*, është i paqëndrueshëm ngase në rastin konkret norma nuk mund të interpretohet në kuptim të ngushtë e shkëputur nga pjesa bazë, por një interpretimi i saktë i normës bëhet nëse i referohemi në mënyrë komulative nga nenin 11 deri tek neni 22 i këtij ligji i përcaktuar si KREU III-PRANIMI, EMËRIMI DHE KUSHTET E PUNËSIMIT, ndërsa sipas nenit 23 paragrafi 1 dhe nën paragrafët e tij të Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës nëpunësit civil i kategorizon si në vijim: *“1. Personeli i punësuar në Shërbimin Civil ndahet në katër (4) kategori funksionale: 1.1. nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues; 1.2. nëpunës civilë të nivelit drejtues; 1.3. nëpunës civilë të nivelit profesional; 1.4. nëpunës civilë të nivelit tekniko – administrativ”*, nga rrjedh se ndërlidhja që pala ankuese i bën paragrafit 1 dhe 2 të nenin 16 të Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës është i paqëndrueshëm ngase me nenin 16 përcaktohet *“Lëvizja e zyrtarëve drejtues brenda shërbimit civil”*, dhe se paragrafi 2 i këtij neni nuk flet për zyrtarin e lartë drejtues në mënyrë taksativ, por për zyrtarin- duke iu referuar paragrafit 1 apo pozitive drejtuese të cilët kanë drejtë të caktohen në grada ekuivalente ndërsa siç keni specifikuar edhe vetë në ankesën e parashtruar me datë 13.12.2021 dhe në provat e bashkangjitura vetë të saj, ankuesi potencon që pozita e Sekretarit të Përgjithshëm dhe e Drejtorit të Qendrës Mjekësore të Forcës nuk janë pozita me grada ekuivalente dhe mbi këtë bazë interpretimi i normës dhe pretendimi ankimor me qëllim të përligjjes së Akt emërimit të datës 25.06.2019 janë të pathemelta dhe të pabazuara.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të tjera ankimore të ankuesit të parashtruara në ankesën e datës 23.12.2021 si dhe parashtresës së datës 02.02.2022 ndërlidhur me paligjshmërinë e Vendimit Nr.14/46 të Qeverisë së republikës së Kosovës i datës 30.11.2021 si dhe Vendimit Nr.prot:3052 të Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes i datës 13.12.2021 me arsyetimin se të njëjtat janë nxjerr në kundërshtim me dispozitat e aplikuara të ligjit material si dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka analizuar dispozitat e Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 132 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se: *“Organi epror, me akt administrativ, do të refuzojë ankesën nëse ankesa është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë. 3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (diapozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar “* dhe ka konstatuar se diapozitivi i të dy vendimeve të ankimuara në këtë ankesë është i ligjshëm ndërsa arsyetimi i dhënë në këtë vendim shërben si plotësim i arsyetimeve të dy vendimeve të lartcekura të goditura me ankesën e ankuesit të datës 23.12.2021 dhe plotësimin e ankesë së datës 02.02.2022, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit sa i përket ligjshmërisë së vendosjes janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1214/2021

Flakron GASHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

Kryeministrit të Republikës së Kosovës

Përfaqësuesit të autorizuar, Avokat

Sekretarit të Ministrisë Mbrojtjes;

Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë Mbrojtjes dhe

Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit

Arkivit të KPMSHCK- së.

